

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
ZYRA E KRYEMINISTRIT - UREDI PREMIERIA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Origjinalit  
Orig. Unit: 02

Nr. Post  
Post No.: 1663/5

Nr. Fletëve  
Br. shantës: -4-

Data:  
Datë: 28 / 07 / 20 21

Prishtinë/a



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**  
**Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General**

Date: 28.07.2021  
Ref: 088 /2021

**Për:** z. Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

**Kopje:** z. Bujar Bajraktari, Udhëheqës i ekipit të Auditimit

**Tema:** Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, të projektit "*Përkrashje për përmirësimin, zhvillimin dhe koordinimin e politikave*"

I nderuar z. Osmani,

Në bazë të kërkesës suaj, gjeni të bashkangjitur Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit "*Përkrashje për përmirësimin, zhvillimin dhe koordinimin e politikave*" i cili përcakton veprimet e ndërmarra, dhe ato që do të ndërmerren, për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e juaj

Për çdo informatë, ju lutemi të mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,

  
**Arben Krasniqi**  
Zv. Sekretar i Përgjithshëm

## Hyrje

Ky Plan në përgjithësi prezanton veprime të cilat janë marrë dhe që do të merren për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për Raportin Financiar Vjetor të Projektit të SIDA-së “Përkrahje për përmirësimin, zhvillimin dhe koordinimin e politikave”, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjatë auditimit në Raportin Financiar Vjetor të Projektit të SIDA-së ka dhënë 2 rekomandime.

Menaxhmenti i ZKM-së është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet në këtë raport.

Zyra e Kryeministrit do të bëjë përpjekje për të adresuar rekomandimet e dhëna dhe synon në vazhdimësi të bëjë përmirësimin e planifikimit të shpenzimeve dhe zbatimin e aktiviteteve për arritjen e rezultateve të projektit.

**PLANI I VEPRIMIT TË MENAXHMENTIT**

Për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Projektit të SIDA-së "Përkrahje për përmirësimin, zhvillimin dhe koordinimin e politikave", në kuadër të Zyrës Kryeministrit (ZKM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (Dokumenti Nr. prot. 1663/3 i datës 30.06.2021)

	Nr. Rendor	Rekomandimet për Projektin	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personat Përgjegjës
1.	<p><b>Çështja C1</b></p> <p><b>Çështjet për pasqyrat financiare</b></p> <p><b><u>E gjetura</u></b></p> <p>Sipas nenit 8 të rregullores MF – nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga Organizatat buxhetore, si dhe në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të bazuar në para gatshme, (shpenzimet) njihen kur ato paguhen nga llogaria e Thesarit.</p> <p>Shpenzimet e prezantuara në pasqyrat financiare për vitin 2020 janë 97,429€ ndërsa shpenzimet e projektit sipas shënimeve të Thesarit janë 97,187. Pra ekziston një diferencë prej 241. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk është bërë një barazim adekuat në mes zyrtarit financiar të projektit dhe zyrës së financave në ZKM.</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet që Pasqyrat Financiare të projekteve të ardhshme të përgatiten vetëm pasi që të jetë siguruar barazimi i informatave financiare në mes projektit dhe me zyrën së financave të ZKM-së.</p>	<p>Është përgatitur plani i detajuar i aktiviteteve të projektit për vitin 2021 në përputhje me planin e buxhetit.</p> <p>SKQ do të përkushtohet që këto të jenë të harmonizuara gjatë gjithë vitit dhe realizueshmëria e buxhetit të jetë në nivel më të lartë.</p> <p>Sa i përket diferencës 241€, menaxhmenti i projektit në SKQ do të sigurohet që vlerat e pasqyrave financiare të jenë në përputhje të plotë me ato të Thesarit (SIMFK)</p> <p>Vlen të përmendet që për shkak të pandemisë COVID 19, nuk janë realizuar shumica e aktiviteteve</p>	<p>Janar-Dhjetor 2021</p>	<p>Menaxhmenti i projektit nga SKQ dhe Zyra për buxhet dhe financa</p>



<p>2. <b>Çështja B1</b></p> <p><b>Vonesa në mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare</b></p> <p><b>E gjetura</b>  Neni 8 i Udhëzimit Administrativ 2004/07 për udhëtime zyrtare thekson që kërkesa për kompensim dhe për mëditjen së bashku me të gjitha dëshmitë e shpenzimeve duhet të dorëzohen tek shërbimi për buxhet dhe financave brenda 15 ditësh nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar.</p> <p>Nga mostrat e testuara të avanceve për udhëtime zyrtare, kemi vërejtur në 16 raste ( në shumë prej 4.853 ) se avancet e dhëna nuk ishin arsyetuar dhe mbyllur me kohë. Vonesat ishin deri në 40 ditë. Ndërsa, në 9 raste kemi identifikuar që në formular mungon data e barazimit të mbylljes/kthimit të mjeteve nga zyrtari që kishte udhëtuar. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve për mbylljen me kohë të avanceve dhe aplikimit të dobët të llogaridhënies nga Departamenti i financave ndaj zyrtarëve shfrytëzues të këtyre avanceve.</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me Sekretariatin Koordinues të Qeverisë(SKQ) dhe zyrën e financave duhet të sigurojnë që në projektet e ardhshme të gjithë zyrtarët që shfrytëzojnë avance për udhëtime zyrtare, brenda 15 ditësh nga dita e kthimit nga udhëtimi, të barazohen me zyrtarin përkatës të financave.</p>	<p>ZBF dhe SKQ do të adresojnë këtë të gjetur duke u kujdesur në zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare në të ardhmen. Para dhe pas çdo udhëtimit zyrtarëve që do të bëjnë kërkesën për hua paraprake do tu dërgohen me kohë njoftimet për përmbushjen e obligimeve të zyrtarëve që udhëtojnë në përputhje me Udhëzimin Administrativ.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2021</p>	<p>ZBF-SKQ</p>
---	---	---	---------------------------	----------------